KOSOVA

we want
që duam
koje hoćemo

Siguri Sociale
Zhvillim Ekonomik
Punë dhe jetë e Dinjitetshme

Supported by:
FRIEDRICH EBERT STIFTUNG
Büro Kosovo

KOSOVA

we want
që duam
koje hoćemo

Çka është Kosova që duam?

Kosova që duam është platformë për bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve të organizatave të shoqërisë civile, qytetarëve dhe grupeve të ndryshme të interesit publik rreth një koncepti të përbashkët për rritje të mirëqenies dhe jetës së dinjitetshme përmes arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës, shëndetësisë publike bashkëkohore, zhvillimit të qëndrueshëm dhe qeverisjes së mirë.



THE KOSOVO WE WANT
#StandOutFromtheCrowd
KOSOVA

KOSOVA
we want
që duam
koje hoćemo

Kur u iniciua platforma?

Një vit më parë, më 23 Maj 2018, me përkrahjen e Friedrich Ebert Stiftung, rreth 200 pjesëmarrës nga rreth 100 organizata dhe institucione u bashkuan për të identifikuar së bashku problemet kryesore me të cilat ballafaqohen dhe preokupohen qytetarët e Kosovës.

Si punuam?

“Dhoma (hapësira) e mendimit” nga Denkraum (gjermanisht) është një koncept inovativ në menaxhimin e projekteve, i dizajnuar me idenë e krijimit të hapësirës për një mendim të hapur dhe njëkohësisht një proces të mendimit të strukturuar lidhur me vendimet e rëndësishme për politikat e shoqërisë. FES ka përdorur këtë koncept me sukses në kontekstin gjerman.

Përfaqësuesit nga shoqëria civile, politikanët, ekspertët dhe qytetarët janë ftuar për të ofruar guximin e tyre dhe që bashkë "përtej punëve të veta ditore", të mendojnë dhe të balancojnë konceptet dhe pikëpamjet e tyre profesionale, me qasje politike, zgjidhje të mundshme dhe nevoja të qytetarëve.

Cdo grup kishte për detyrë të identifikonte sfidat, ti prioritizonte ato dhe të propozoheshin intervenime konkrete.



Të pesë “Dhomat e mendimit” e platformës Kosova që duam, janë dizajnuar për të akomoduar diskutime dhe aktivitete dinamike nga grupet punuese gjatë gjithë vitit, duke rezultuar me një udhërrëfyes të qartë dhe një plan veprim të përbashkët, të nënshkruar prej gjithë pjesëmarrësve, si një përkushtim i përbashkët për të punuar për një Kosovë më të mirë që ne gjithë duam.

Moto e platformës

BASHKËPËRGJEGJËSIA

NjË SINONIM PËR NJË RRUGË DYKAHËSHE ME KONTRIBUTE DHE TË DREJTA

Një marrëdhënie në mes të qytetarëve duhet të zhvillohet dhe duhet të jetë e tillë dhe e bazuar në respekt dhe besim, nga të dyja anët. Qytetarët e cili do shteti kanë të drejtë për një mbështetje bazike në shumë aspekte të jetës si në, arsim, siguri sociale, korniza ligjore, etj. Por, ata po ashtu kanë obligime ndaj shtetit të tyre. Tatimet dhe kontributet tjera për sistemet e solidaritetit janë e vetmja mënyrë për realizimin e të drejtave të tyre në mënyrë të duhur.

Cili është qëllimi i kongresit të dytë?

Ne duam të prezantojmë rezultatet e punës tonë për një vit. Ne duam të dëgjojmë pyetjet dhe komentet tuaja. Duam që ju t'i bashkoheni platformës në kapacitet individual ose si përfaqësues i organizatës/institucionit. Bashkë jemi më të fuqishëm në presionin ndaj politikanëve për të bërë punë më të mirë në interesin e qytetarëve.
Bashkë jemi më të suksesshëm në realizimin e qëllimeve të kësaj platforme.

Kush është aktualisht anëtar i platformës?

Shumë pjesëmarrës individual që përfaqësojnë veten, një grup interesi apo që punojnë në institucione private dhe publike janë tashmë anëtarë të platformës që nga kongresi i parë. Përvec kësaj, shumë organizata të shoqërisë civile në tërë Kosovën janë poashtu pjesë e platformës dhe ne shpresojmë që ky numër të rritet në vijim.

Kush mund t"i bashkohet platformës?

Cdo qytetar, organizatë e shoqërisë civile dhe organizatë politike që pajtohet me qëllimet, misionin dhe parimet e kësaj platforme është l lirë të bashkohet në cdo fazë të punës, tash dhe më vonë. Na duhet kontributi l secilit nga ju për Kosovën që duam.

Si mund të bashkohem?

Mund të bashkohesh në platformën Kosova që duam duke nënshkruar formën e mëposhtme dhe duke e vendosur atë në kutitë speciale për këtë cështje. Nënshkrimi i kësaj forme dëshmon pajtimin tuaj për të qenë pjesë e platformës , qëllimeve të saj, metodave të punës dhe gatishmërinë tuaj për të kontribuar në mënyrë aktive si qytetar, ekspert apo përfaqësues i organizatës në aktivitetet e ndryshme të platformës, grupeve përkatëse të punës gjithnjë deri sa i ndajmë së bashku të njëjtat vlera dhe parime.

DEKLARATA E BASHKIMIT DHE PAJTIMIT ME QËLIMET DHE PARIMET E PLATFORMËS “KOSOVA QË DUAM”

Unë _____ dëshiroj të jem pjesë e platformës Kosova që duam
Emri & Mbiemri

✓ E ofroj pjesëmarrjen time aktive në aktivitetet e platformës në kapacitetin:

a ☐ qytetar /individ

b ☐ përfaqësues i organizatës _____
Emri i organizatës

c ☐ Përfaqësues i partisë politike _____
Emri i partisë politike

✓ Dua të jem aktiv në grupet punuese :

☐ Edukim për zhvillim dhe punësim

☐ Qytetari aktive për Qeverisje të Mirë

☐ Zhvillim Ekonomik dhe Krijim të Vendeve të Punës

☐ Shëndetësi dhe Mirëqenie

☐ Punë dhe Jetë të Dinjitetshme

Kontaktet

Tel: _____

email: _____

vetëm për qëllim të kontaktimit tuaj për aktivitete dhe publikime

Nënshkrimi juaj

_____

Të drejtat e qytetarëve: Zhvillimi ekonomik – Jetë e denjë – Siguri sociale – Punë e dinjitetshme

Qytetarët e Kosovës e marrin të drejtën që të fokusohen, organizohen, aktivizohen dhe të punojnë në zhvillimin **demokratik** të shtetit të vet, në të cilin **qeverisja e mirë** dhe s**istemi gjithpërfshirës i sigurimit social** është i mundshëm dhe i garantuar përmesmodelit të **zhvillimit ekonomik** të qëndrueshëm, i cili përfshinë shkathtësitë dhe kulifikimet që janë si rezultat **i një sistemi arsimor gjithpërfshirës dhe cilësor. Qytetarët duan** që të shqyrtojnë me kujdes se çfarë bëjnë politikanët, deputetët e kuvendeve dhe qeveritarët për përmbushjen e këtij shteti të dëshiruar, meqenëse që të gjithë janë të deleguarit e qytetarëve, duke përdorur një qasje proaktive për proceset e hartimit të politikave.

Qytetarët janë në dijeni të shumë problemeve të veçanta në Kosovë, si shteti më i ri demokratik në Evropë dhe si një shtet fqinj i rajonit i cili akoma është i ndikuar nga luftërat e fundit dhe pasojat e tyre. Për shumicën e këtyre problemeve nevojitet kohë që ato të mund të zgjidhen në mënyrë të duhur. Krahas kësaj, ekzistojnë edhe sfidat, me të cilat qytetarët ballafaqohen çdo ditë, e të cilat duhet të adresohet në mënyrë efektive sa më shpejt. Zhvillimi i një perspektive sipas këndvështrimit të qytetarëve **nuk duhet të shtyhet për më vonë** nga cilido politikan, kuvend ose qeveri.

Qytetarët tani duan **të ngriten** dhe të **angazhohen për gjetjen e zgjidhjeve më të mira** dhe **perspektivave të reja** në një vend i cili **ende vuan nga papunësia**, **kujdesi social më i dobët, struktura jodemokratike dhe të korruptuara dhe – për pasojë – paraqitet emigrimi dhe largimi nga vendi i ekspertëve të rinj.** Qytetarët jo vetëm që kërkojnë, por a**ta duan të ofrojnë idetë e veta**, **mbështetjen e tyre dhe bashkëpërgjejgësinë** duke kontribuar për politikat e ardhshme të cilat **janë shumë më shumë të fokusuara në nevojat e qytetarëve** e që bazohen në një kuptim të përbashkët të sforcimit për të ardhmen e vendit.

Qytetarët e ndjejnë **vendin e tyre sikurse shtëpinë e tyre** – dhe prandaj ata duan ta **ruajnë dhe të kujdesen për të,** sikur për shtëpinë e tyre. Në Kongresin e Parë Nacional, prej qytetarëve u përcaktuan **pesë fusha të angazhimeve politike,** të cilat duhet të jenë në fokus – por të **lidhura me njëra tjetrën,** meqë janë të përfshira në mënyrë të shumëfishtë

KOSOVA
we want
që duam
koje hoćemo

Kongresi i Dytë Nacional
Prishtinë, 23 maj 2019

Amfiteatri afër Hotelit Grand
Sheshi „Zahir Pajaziti"

AGJENDA

Siguri Sociale / Zhvillim Ekonomik / Punë dhe Jetë e Dinjitetshme

09:00h	Hyrja, Regjistrimi, Kafeja
09:30h	Përse qytetarëve u duhet platforma e jonë e përbashkët?
09:45h	Mirëseardhje dhe fjalimet hyrëse **Frank Hantke**, FES-Prishtinë
10:00h	Prezantimi i punës së vitit të kaluar të KWW-së dhe Prezantimi i rezultateve të grupeve punuese Moderimi: **Besa Luzha,** FES-Prishtinë
10:15h	Arsimi për Zhvillimin e Aftësive për Punësim
10:35h	Zhvillimi Ekonomik dhe Krijimi i Vendeve të Punës
10:55h	Politikat Shëndetësore dhe të Mirëqenies Sociale
11:15h	Punë dhe Jetë e Denjë
11:35h	Aktivizmi Qytetar për Qeverisje të Mirë
12:00h	Prezantimi i programit-platformë, duke paraqitur planin e veprimit dhe thirrja për ta nënshkruar *regjistruar në platformë.
12:15h	Nënshkrimi publik
12:30h	**Komentet përmbyllëse** Pritje, Tregu u Mundësive, Rrjetëzimi
14:00h	Përfundimi i Kongresit të dytë të KWW

EDUKIM PËR PUNËSIM DHE ZHVILLIM

Supported by:

FRIEDRICH EBERT STIFTUNG
Büro Kosovo

Grupi për arsim është grupim jo-formal i disa organizatave me eskpertizë në fushën e arsimit, brenda platformës Kosova që duam, i bashkuar për të ngritur çështjet prioritare në fushën e arsimit.

Ky grup avokon dhe vepron së bashku në mënyrë që politikat arsimore të trajtohen me prioritet dhe profesionalizëm, duke përfshirë të gjithë akterët në zhvillimin dhe monitorimin e reformave arsimore.

Grupi koordinohet nga përfaqësues të FES dhe partnerët pjesëmarrës. Në mes të dy kongreseve puna e grupit është koordinuar nga Kolegji Riinvest me aktivitetet e fokusuara rreth konsultimit aktiv të dokumenteve e politikave dhe të grupeve të interesit (nxënësit, prindërit, mësimdhënësit dhe akterët e tjerë) rreth çështjeve të prioritizuara në kongresin e parë. Synimi ishte shtyerja e iniciativave konkrete të platformës.

Ky grup është pjesë edhe e iniciativave të tjera në këtë fushë dhe koordinohet me akterët kryesorë, donatorët në sektorin e arsimit dhe të gjithë të interesuarit për të ndërtuar një zë të përbashkët dhe përpjekje të qëndrueshme.

Idetë/cështjet/intervenimet e propozuara pas kongresit të parë :

Arsimi parauniversitar

- Strategjia specifike për arsimin parashkollor / edukimin e hershëm
- Strategjia specifike për përkrahjen e fëmijëve me nevoja speciale
- Analiza për zhvendosjen e buxhetit në arsim
- Trajnimi i mësimdhënësve (metodat e mësimdhënies, vlerësimet, zhvillimi i shkathtësive të buta, integrimi i kurrikulës)
- Integrimi i kurrikulës (Balancimi i përmbajtjes me zhvillim të shkathtësive)
- Analizimi i moshës së mësimdhënësve në arsimin parauniversitar
- Zhvillimi i performancës dhe i politikave të avancimit
- Orët mësimore shtesë dhe aktivitetet ekstrakurrikulare – udhëzime dhe nxitje
- Fond për projekte të udhëhequra nga nxënësit/mësimdhënësit dhe prindërit
- Aktivitete dhe mekanizma për orientim në karrierë
- Projekt fond për Strategjinë për përmirësimin e shkollave
- Raport mbi pabarazinë
- Hulumtim për rininë e mjedisit rural

Arsimi profesional

- Projekt fond për Strategjinë për përmirësimin e shkollave
- Zhvillim i vlerësimit të performancës dhe i politikave të avancimit
- Hulumtimi për analizim të tregut
- Vlerësimi i formulës së financimit dhe buxhetit për arsimin e AP
- Trajnim për mësimdhënësit
- Fushata avokuese për përkrahjen e arsimit për AP dhe luftimi i stereotipeve të bazuara në gjini

Arsimi i lartë

- Trajtimi i ndasive në bazë të gjuhës gjatë pjesëmarrjes në tregun e punës (dokument i politikave)
  Formula financiare për arsimin e lartë
- Analizë nga vlerësimi i buxhetit për hulumtim
- Projekt për zhvillimin e mësimdhënësve
- Politikat ANTI-korrupsion dhe analiza e praktikave
- Raport nga analiza e proporcionit - student/staf

Aktivitetet e realizuara në mes të dy kongreseve

. Diskutim mbi Ligjin për Arsimin e lartë -me rektorët dhe menaxherët e lartë të institucioneve të AL
2. Punëtori me studentët e AL mbi pjesëmarrjen në zhvillimin e cilësisë
3. Papunësia në Kosovë-debat mbi konceptin dhe matjen
3. Arsimi parauniversitar-Përfshirja e prindërve në arsimimin e fëmijëve
4. Debatet shkollore mbi Arsimin
5. Punëtorëi e zhvillimit të animacionit me nxënësit e nivelit parauniversitar: Si mësojmë?
6. Qasja në arsim për grupet e margjinalizuara-në bashkëpunim me Qendrën burimore -Xheladin Deda
7. Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm
9. Analiza e politikave arsimore të partive politike -legjislacioni dhe zbatimi
10. Video documentary on education area related problems
11. Studim: Rinia Rurale-barrierat për shkollim dhe punësim





ZHVILLIM EKONOMIK
DHE VENDE PUNE

Supported by:

FRIEDRICH EBERT STIFTUNG
Büro Kosovo

Grupi për Zhvillim Ekonomik dhe krijim të vendeve të punës brenda platformës Kosova që duam synon të integrojë dhe koordinojë përpjekjet e të gjtihë akterëve që sigurojnë një qasje të zhvillimit të qëndrueshëm të Kosovës me sistem të mënaxhimit efficient të resurseve njerëzore e natyrore, investime të jashtme, sektorit privat të qëndrueshëm dhe dinamik të ndërtuar nga kompetencat dhe ndërmarrësia.
Diskutimi në formën e stuhisë së mendimeve në kongres i ka përvijuar disa nga çështjet ekonomike më urgjente në Kosovë. Si një vend me shkallën më të lartë të papunësisë dhe nivelin më të ulët të produktivitetit në Evropë, Kosova ballafaqohet me sfida të shumëfishta në rrafshin e arsimit dhe të integrimit të fuqisë së re punëtore në tregun e punës. Veç kësaj, Kosova e ka shkallën më të ulët të tregtisë me shtetet tjera anëtare të CEFTA-s, veçanërisht në kuptim të shkallës së eksportit.

Prandaj, të frymëzuar nga treguesit kryesor për prodhimtarinë dhe punën, dikutimi i drejtuar nga pjesëmarrësit e grupit për zhvillim ekonomik dhe krijim të vendeve të punës e ka nënvizuar nevojën për një vizion ekonomik më të qartë dhe një strategji për trajtimin e disa mikro dhe makro problemeve dhe mundësive. Për rrjedhojë, pjesëmarrësit kanë dalë me rekomandime për një studim të mëtejm të tregut me qëllim të identifikimit të sektorëve dhe intervenimeve të cilat do të mund të përmirësonin perspektivën ekonomike të Kosovës.

Problemet që u identifikuan në kongresin e parë:
Mungesat në Tregun e punës

- Mungesa e informacionit për shkathtësitë dhe kualifikimet në tregun aktual të punës
- Shpërputhja mes sistemit arsimor the tregut të punës, që rezulton me punëtorë të pakualifikuar në tregun e punës
- Çështja e ikjes së trurit, ku fuqia punëtore e shkathtë po gjenë vende pune jashtë Kosovës, pra duke migruar në shtetet e Evropës
- Mungesa e të dhënave dhe e informacionit të disponueshëm në sektorin privat për prodhimin e mallrave dhe ofrimin e shërbimeve
- Mungesa e bashkërendimit mes sektorit publik dhe atij privat për të identifikuar sektorët më konkurrues
- Mungesa e barrierave (d.m.th., kuotave) për mbrojtjen e kompanive private

Aktivitetet:

Grupi ka vendosur të ndërmerret një hulumtim serioz për konkurrueshmërinë, që do të vlerësojë konkurrueshmërinë e sektoreve dhe nënsektorëvë të ekonomisë në Kosovë, me focus në industritë që kanë potencial të rrisin numrin e punëtorëvë, pagat, eksportin dhe indikatorë të tjerë të rritjes.

Aktivitetet në vijim:
Takimi me akterët relevantë
Diskutimi I strategjisë së propozuar
Krijimi i një plani aksional të përbashkët
Avokimi I rezultateve te akterët relevantë
Shpërndarja e rezultateve / Infografika/blogje /media sociale dhe debate publike

4 MAIN RESULTS

The main results that were obtained after measuring the six economic development indicators are as follows:

Number of companies

- The best performing sector in this section is wholesale and retail trade.
- The second best performing sector is manufacturing due to its large relative size.
- At the bottom of the list for the pre-selected sectors is wholesale and retail trade due to the decrease in productivity over the last six years within the sector, as shown by the CAGR.



- G – Wholesale and reatil trade; repair of motor vehicles and motorcycles
- C – Manufacturing
- I – Accommodation and food service activities
- F – Construction
- M – Professional, scientific and technical activities
- Other

Fig.1 Share of firms by sector

Employment

- The best performing sector in terms of employment is the wholesale and retail trade sector. Wholesale and retail employs around 29.99% of Kosovo's employed population and its CAGR is 8.6%.
- Manufacturing is the second largest sector in terms of employment with 13.04% of the labor force employed there.
- At the bottom of the list from the pre-selected sectors is electricity, gas, steam, and air conditioning supply along with activities of households as employers, while mining and quarrying is last out of the 22 sectors.

- G – Wholesale and reatil trade; repair of motor vehicles and motorcycles Total
- C – Manufacturing Total
- F – Construction Total
- K – Financial and insurance activities Total
- I – Accommodation and food service activities Total
- Other



Fig.3 Share of Employment by Sector


1 Strategy
Competitiveness Assessment Study
3 Sectors
Manufacturing
Construction
Admin Services
5 Subsectors and Interventions
Subsector 1
Subsector 2
Subsector 3
Subsector 4
Subsector 5

AKTIVIZËM QYTETAR
PËR QEVERISJE TË MIRË

Supported by:

FRIEDRICH EBERT STIFTUNG
Büro Kosovo

Grupi për Qytetari Aktive dhe Qeverisje të Mirë brenda platformës Kosova që duam ka për synim të avokojë dhe të nxisë pjesëmarrjen e rregullt aktive të qytetarëve dje përfshirjen e tyre në proceset e zhvillimit të politikave dhe të vendimmarrjes në nivel qendror dhe local, me qëllim të mbrojtjes së interesit public përmes llogaridhënies, transparencs dhe efficiencies, parime kryesore te qeverisjes se mire.

Brengat e identifikuara në kongresin e parë ishin:

- Luftimi i klientelizmit;
- Rrritja e qasjes në informacion;
- Forcimi i rolit të arsimit në ngritjen e aktivizmit qytetar; ·
- Adresimi i mungesës së stimulimeve (morale, materiale dhe institutionale) për grate, të rinjtë komunitetet dhe grupeve të margjinalizuara për aktivizëm qytetar dhe vullnetarizëm.

Intervenimet e propozuara:

- Aktivitete të Edukimit Qytetar për angazhim të komunitetit
- Konsultime publike për Reformën e Sistemit Arsimor
- Rregullativa dhe mekanizma për konsultim public në fazë të hershme
- Aktivitete për të siguruar transparencë në rekrutim dhe prokurim publik
- Puna me përfaqësuesit lokalë të jetë më gjithëpërfshirëse

Aktivitetet:

Në kuadër të platformës Kosova Që Duam, me qëllim të identifikimit të kërkesave të qytetarëve për një qeverisje të mirë dhe me synim të nxitjes së angazhimit të qytetarëve, u mbajtën 9 diskutime publike në 9 komuna të ndryshme. Diskutimi ishte i ndarë në dy pjesë: Organizatorët në pjesën e parë prezantuan platformat të cilat lidhen me qytetari aktive, ndërsa në pjesë të dytë debati u hap për pjesëmarrësit, ashtu që të mund të adresonin kërkesat, ankesat dhe propozimet e tyre për qeverisje të mirë.
Gjate diskutimeve u prezantuan 3 platforma per qeverisje te mire dhe qytetari aktive.

Komuna	Data	Pjesëmarrës	Gra	Burra
Lipjan	10 Shtator, 2018	63	32	31
Shtime	14 Shtator, 2018	37	16	21
Mitrovica	21 Shtator, 2018	13	8	5
Klina	5 Tetor, 2018	33	16	14
Podujeva	12 Tetor 2018	23	10	13
Dragash	7 Nëntor 2018	26	17	9
Gjilan	15 Nëntor, 2018	21	14	7
Gjakovë	27 Nëntor, 2018	24	15	9
Prizren	30 Nëntor, 2018	16	10	6
Total		**256**	**138**	**115**

1. D+ prezantoi platformën "Qeverisjatani.info", e cila qytetarëve u ofron informata lidhur me atë se sa janë plotësuar premtimet zgjedhore nga Qeveria e Kosovës.
2. Lëvizja FOL prezantoi "https://ëëë.prokurimihapur.org/" , qëllimi i të cilës është rritja e transparencës të shpenzimeve publike.
3. Kurse D4D prezantoi http://qeverismire.info/, platformë kjo ku qytetarëve u ofrohet qasje në parimet bazë të qeverisjes së mirë, ashtu që në qytetarët të jenë të njoftuar se si ndërveprimet e caktuara me komunën do të duhej të shkonin nën një qeverisje të mirë.

256 qytetarë moren pjesë në këto diskutime

Anëtarët e grupit:

Democracy +,
Levizja FOL,
Demokraci për Zhvillim



SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE

Supported by:

FRIEDRICH EBERT STIFTUNG
Büro Kosovo

Grupi për shëndetësi dhe politikat e mirëqenies sociale brenda platformës Kosova që duam angazhohet për një sistem modern, efikas të shendetësisë dhe të sigurisë shoqërore me shërbime të qasshme dhe të përballueshme [ër të gjithë qytetarët e Kosovës.

Anëtarët e grupit dhe dy nëngrupeve kanë identifikuar problemet dhe I kanë prioritizuar ato së bashku në kongresin e parë duke I adresuar disa nga këto prioritete me aktivitetet e organizuara në periudhën ne mes të dy kongreseve.

Shëndetësia

- Probleme dhe mangësi në menaxhim
- Probleme me plotësim me staf dhe punësim
- Shërbime të cilësisë joadekuate
  Nevoja për zhvillim të vazhdueshëm
- profesional dhe arsimim
  Mungesë e llogaridhënies
- Paga jo të njëjta
- Mungesa e monitorimit të duhur dhe e vlerësimit
- Privacia e pacientëve

Mirëqenia sociale

- Pensionet
- Skemat Sociale
- Familja dhe politika të tjera
- Një jetë më e mirë për grupet e margjinalizuara në shoqëri Strehimi
- Social
- Shërbimet Sociale

Sfidat:

- Sigurimi shëndetësor
- Mjekët e trajnuar migrojnë jashtë vendit
- Legjislacioni
- Cilësia e shërbimeve shëndetësore

Prioritetet

- Zhvillimi i strategjive specifike për tri prioritetet kryesore:
- Arsimi shëndetësor,
- Mjetet financiare/ financimi/infrastruktura Riorganizimi/ reforma në sektorin e shëndetësisë dhe përmirësimet e nevojshme në menaxhim

Sfidat e identifikuara dhe të

- **prioritetizuara nga pjesëmarrësit:**
- Krijimi i fondit për mbrojtjen sociale;
- Kujdesi për fëmijët /politikat kundër abuzimit
- Decentralizimi i shërbimeve sociale (MPMS)
- Ri-identifikimi i grupeve të mbrojtura sociale
- Pushimi lehonisë
- Strehimi social publik
- Barazia në shpërndarjen e buxhetit publik
- Politikat për prindë të vetëm
- Reforma e pensioneve

Aktivitetet në mes të dy kongreseve

Shëndetësia

- Debat: Ikja e mjekëve të rinj nga Kosova
- Debat: Humbja e besimit në institucionet shëndetsore në vend
- Debat: Legjislacioni bazik për shëndetesinë si kornizë orientuese për një sistemi efikas e modern shëndetësor
- Analizë dhe debat: Revidimi i listës esenciale të barërave
- Kampanjë: Dita botërore kundër stigmatizimit te obezitetit
- Kampanjë: Edukimi shëndetësor
- Kampanjë: Shëndeti oral tek femijët/ si dhe shëndetit reproduktiv tek gratë
- Hulumtim dhe diskutim rreth përdorimit të antibiotikëve
- Debat: Skema e sigurimeve shëndetësore
- Hulumtim dhe vizualizim: Organogrami i sistemit shëndetësor në Kosovë

Mirëqenia dhe siguria Sociale

Social policies –activities

- Takimi i grupit për vendosjen e prioriteteve
- Raporti dhe dokumentari “Të moshuarit në Kosovë”
- Raporti dhe diskutimet për “Vdekjet e heshtura”
- Konferenca: Cfarë shteti të mirëqenies sociale duam për Kosovën?
- Punëtori për finalizimin e Marrëveshjes Kolektive
- Punëtori për finalizimin e koncept dokumentit për rregullimin e fushës së pensioneve dhe përfituesve të mbrojtjes sociale
- Vizitë studimore për Komisionin Parlamentar për Shëndetës, Punë dhe Mirëqenie në Slloveni

SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE

Grupi për punë dhe jetë të dinjitetshme brenda platformës Kosova që duam angazhohet dhe avokon për sigurimin e standardeve minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë, bazuar në standardet e EU dhe të ILO-s e të drejtave të garantuara njerëzore për jetë të dinjitetshme sipas konevntave ndërkombëtare .

PUNË DHE JETË TË DINJITETSHME

Pas diskutimit dinamik dhe konstruktiv të përfaqësuesve të partnerëve social (sindikatat, punëdhënësit, shoqëria civile, institucionet) u identifikuan disa prioritete:

- Mundësitë e barabarta
- Pagat e barabarta
- Page minimale e dinjitetshme
- Punë të sigurta
- Luftimi I informalitetit
- Plotësimi I Ligjit të punës (pushimi i lehonise, orët e punës, kontratat etj) Siguria dhe shëndeti në vendet e punës
- Sigurimet shëndetësore
- Ngacmimet seksuale në vendet e punës
- Organizimi sindikal në sektorin privat

Intervenimet e propozuara :

- Kontratat kolektive duhet të kompletohen nga fundi i këtij viti
- Amandamentimi i Ligjit të Punës (dispozita për pushimin e lehonisë, orari i punës, dhe çështje tjera të lidhura, Ligji për Këshillin Ekonomik dhe Social)
- Debatet dhe sesionet e informimit për këto çështje duhet të jenë prioritet i kësaj "Dhome të
- Mendimit" gjatë javëve dhe muajve të ardhshëm.
- Dispozita për pushimin e lehonisë të diskutohet për nga qasja e politikave sociale dhe perspektiva e mbrojtjes së fëmiut dhe familjes.
- Kushtet e dinjitetshme të punës çojnë kah jeta e dinjitetshme për çdo qytetar të Kosovës dhe kjo duhet të jetë e arritur ambicioze e këtij grupi gjatë punës pas këtij kongresi.

Supported by:
FRIEDRICH EBERT STIFTUNG
Büro Kosovo

Aktivitetet në mes të dy kongreseve

- Konferenca: “Mekanizmat Institucionalë për Mbrojtjen e Punëtoreve”
- Tryeza me Komisionin për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie sociale për ligjin mbi Inspektoratin e Punës
- Organizimi i sindikatave në sektorin privat në parteritet me KAMA dhe BSPK
- Mbështetja e sindikatave në organizimin e ngjarjes për të drejtat e punëtorëve
- Konferenca rajonale e rrjetit të grave sindikaliste të punësuara në polici
- Hulumtimi dhe tryeza: Vdekjet e heshtura
- Konferenca rajonale për siguri dhe shëndet në punë (KOSHA)
- Tryeza për siguri dhe shëndet në punë në partneritet me Sindikatën e Doganave të Kosovës
- Punësimi dhe përfaqesimi i gruas në Kosovë
- Analiza e politikave për pagat në sektorin publik
- Vizita në Slloveni e Komisionit për Punë dhe Mirëqenie sociale me fokus amandamentimi I Ligjit për Inspektoratin e Punës
- Debatet live televizive mbi dialogun social dhe cështjet e lidhura me jetën dhe punën e dinjitetshme

Të arriturat:

Si rezultat i aktiviteteve te shumta të shoqërise civile brenda grupit punues nga partnerët kemi arritur disa rezultate qe vlen të përmenden:

- Siguria dhe shëndeti është ne top agjendën e qeverisë dhe kuvendit
- Kuvendi i Kosoves është në proces të amandamentimit të Ligjit per
- Inspektoratin e Punës dhe jemi pjesë përbërëse e grupeve punuese
- Kuvendi i Kosoves është duke e amandamentuar Ligji për Keshillin Ekonomik Social si mekanizëm i dialogut të tre palëve ku ne jemi të ftuar në një pjese të grupeve punuese. Ligji i punës me fokus në pushimin e lehonisë: qeveria është në draftim të këtij ligji
- Reforma pensionale është nisur
- Diskutimet për kontrata kolektive janë në vazhdim
- Paga minimale është propozuar të rritet

PUNË DHE JETË
TË DINJITETSHME

Platforma Kosova që duam gjatë një vitit ka punuar në këto fusha duke i adresuar prioritetet dhe duke propozuar intervenimet konkrete që duam ti ndajmë me ju.

KOSOVA
we want
që duam
koje hoćemo

Observime të përgjithshme:

Janë disa çështje të ndërlidhura të rëndësisë së lartë për të gjitha fushat e adresuara në këtë program:

- Mungesa e llogaridhënies nga ata që marrin pjesë në vendimmarrje
- Ndikimet e interesave afatshkurtëra si motivues për politikëbërje
- Mungesa e përfaqësimit efektiv të punëtorëve dhe qytetarëve në Dialogun Social
- Mungesa e konsensusit nacional të bazuar në Modelin e Shtetit të Mirëqenies me
- Pjesëmarrje
- Informaliteti mbetet një pjesë e rëndësishme të tregut të punës
- Pjesëmarrja e ulët e grave në tregun e punës vazhdon të mbetet sfidë
- Deficitet rreth implementimit të ligjeve ekzistuese, monitorimit dhe vleresimit të tyre janë ende evidente
- Zhvillim jo i mjaftueshëm i sistemeve të pavarura të mbrojtjes sociale prej trupave (institucioneve) që përfshinë të gjithë kontribuesit
- Nivel i ulët i konkurrencës
- Mungesa e bashkëpunimit në mes të qytetarëve dhe spektrit politik

1. Gjërat që mungojnë

- Zbatimi dhe vlerësimi - në përgjithësi - i një legjislacioni pothuajse të mirë dhe i një plani strategjik gjithëpërfshirës.
- Harmonizimi i akteve nënligjore me legjislacionin dhe harmonizimi i çështjeve që ndërthurren në legjislacion.
- Ka mungesë të një kohezioni social lidhur me mundësitë e barabarta për qasjen në arsim, pavarësisht nga përkatësia etnike, gjinore, statusi socio-ekonomik dhe vendbanimi.
- Sistem unik i arsimit për të gjithë banorët e Kosovës.
- Decentralizimi i mëtejmë në nivel të shkollës me shkolla që janë të përgjegjshme dhe llogaridhënëse ndaj komunitetit.
- Pjesëmarrje aktive e aktorëve relevant në arsim (nxënës, prindër dhe komunitete).
- Standarde të përgjithshme dhe specifike për matjen e cilësisë në të gjitha nivelet.
- Arsim për pjekurinë sociale dhe politike.
- Arsim që zhvillon kompetenca e të cilat studentëve (fuqisë punëtore) u mundësojnë që të përgjigjen në mënyrë fleksibile ndaj ndryshimit të kërkesave të tregut.
- Implementim adekuat i kornizës kurrikulare (fokusim në shkathtësi dhe kompetenca).
- Formulë adekuate e financimit dhe infrastrukturë.
- Rekrutim dhe avancim i bazuar në meritë.

2. Gjërat e kërkuara

- Shoqëri Civile aktive dhe palë të interesit në monitorimin dhe vlerësimin e kornizës ligjore.
- Përpjekje paralele dhe të bashkërenduara për zhvillimin e një sistemi gjithëpërfshirës.
- Ristrukturimi i buxhetit për arsimin dhe rritja graduale e tij.
- Barazi për të gjitha grupet e shoqërisë
- Përfshirja sociale për të gjithë fëmijët.
- Më shumë çerdhe për fëmijë dhe më shumë bashkëpunim me komunat.
- Sistem arsimor unik me përgjegjësi dhe llogaridhënie të qartë.
- Pjesëmarrje aktive a palëve të interesit dhe shkolla më të hapura dhe më miqësore.
- Treguesit e përputhjes me legjislacionin.
- Sistemi për Sigurimin e Cilësisë.
- Treguesit e performancës së studentëve dhe të diplomimit.
- Kurrikulet jashtë-mësimore dhe treguesit e aktiviteteve në komunitet.
- Treguesit për shoqërimin – fëmijë dhe prindër.
- Mësimnxënia kreative, zhvillimi i shkathtësive të buta dhe edukimi qytetar përmes mësimnxënies formale dhe informale.

- Kurrikulë e përmirësuar me qasje didaktike koresponduese dhe zhvillim të stafit.
- Kurrikula për të ardhmen e fëmijëve në shoqëri, lidhur me demokracinë dhe botën e punës.
- Përkrahja e talenteve dhe e kreativitetit përmes didaktikës së re në të gjitha nivelet e arsimit
- Ristrukturimi i formulës buxhetore për shkolla dhe universitete.
- Themelimi i standardeve shkollore minimale
- Analiza e tregut të punës.
- Një sistem relevant për trajnimin e mësimdhënësve i cili çon kah licencimi në bazë të vlerësimit efektiv dhe ngritjen e kualifikimit.

3. Realizimi

- Ne do të fuqizonim avokimin për shoqërinë civile dhe palët e interesit përmes reagimit dhe diskutimit publik.
- Ne do të përfshinim OJQ-të dhe palët me interes në raportet vjetore , por edhe në draftimin, ndryshimin dhe monitorimin e zbatimit të kornizës legjislative. 2
  Shoqëria civile dhe palët me interes do të përkrahin shembujt e mirë të përfshirjes.
- Ne do të punonim me grupe të targetuara dhe përfituese (nxënës, prindër, punëtorë arsimor dhe qytetarë) për të rritur ndërgjegjësimin / avokojnë për përfshirje në të gjitha nivelet dhe segmentet.
- Ne gradualisht do të siguronim një vend për secilin fëmijë në kopsht.

- Ne do të zbatonim kornizën e qartë ligjore lidhur me përfshirjen për grupet e nënprivilegjuara dhe fëmijët me nevoja të veçanta. 3
- Ne do të përfshinim shoqërinë civile dhe palët me interes në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta duke i përfshirë edhe komunitetet e ndryshme.
- Ne do të zhvillonim një program për analizimin e problemeve për integrimin e komunitetit serb që dalin për shkak të sistemit të ndarë arsimor.
- Ne do të përfshinim të gjitha grupet etnike për të lehtësuar procesin e transferit drejt sistemit arsimor unik.
- Ne do të ndryshonim legjislacionin, do të kryenim mbikëqyrjen dhe do të gjenim zgjidhje politike për një sistem arsimor unik në Kosovë.4
- Ne do të zhvillonim mekanizma dhe udhëzues për bashkëpunim efektiv me palët me interes dhe shoqërinë civile për pjesëmarrje aktive në arsim përmes inkurajimit dhe mënyrave të ristrukturimit të pjesëmarrjes. 5
- Ne do të përfshinim, inkurajonim dhe fuqizonim OJQ-të dhe palët me interes në monitorimin dhe vlerësimin e treguesëve të cilësisë.6
- Ne do të punonim për më shumë arsim informal – në shkolla, qendra rinore, klube, etj.7
- Ne do të përpilonim një Raport të besueshëm nga Analiza e Tregut të Punës bashkë me kompetencat prej ekspertëve dhe shoqëria civile.
- Ne do të bashkëpunonim me bizneset , komunat dhe shkollat për të përcaktuar modelet dhe profilet.
- Ne do të krijonim një model të ndërmarrësisë për shkollat profesionale / qendrat e kompetencës.

- Ne do të rregullonim licencimin e profesioneve dhe zhvillimin e trajnimeve të mëtejme dhe zhvillimin e një agjencie për zhvillim profesional dhe orientim në karrierë në nivel qendror dhe atë lokal. 8Ne do të përdorim avokimin e shoqërisë civile dhe aktorëve dhe diskutimin publik për të monitoruar dhe vlerësuar zbatimin e kurrikulës së re dhe për të bërë ndërhyrjet e nevojshme në lidhje me cilësinë 9
- Ne do të përfshinim/analizonim modelet e propozuara nga shoqëria civile dhe palët me interes me qëllim të përshtatjes së formulës për financimin e arsimit lidhur me prioritetet strategjike.10Ne do të organizonim monitorimin e punësimit dhe promovimin bashkë me mësimdhënës dhe administratorë dhe bashkë me shoqërinë civile dhe palët me interes.

1. Gjërat që mungojnë

- Besimi dhe llogaridhënia në institucionet publike
- Tregu i hapur i punës në sektorin pa ndërhyrje nga politika dhe grupet tjera të interesit
- Përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje, veçanërisht në nivelin lokal
- Edukim qytetar gjithpërfshirës
- Motivim dhe vullnet i përgjithshëm për t'u angazhuar për të drejtat e qytetarëve

2. Gjërat e kërkuara

- Fuqi punëtore me shkathtësi të mira në administratën publike – të jenë aty për shkak të aftësive, e jo të nepotizmit ose klientelizmit
- Transparencë e plotë për punësimet në administratën publike
- Regjistrimi i obligueshëm nga agjencia për punë i të gjitha vendeve të punës në sektorin privat
- Një sistem i përgjithshëm i dëgjimeve publike para vendimmarrjes lidhur me interesat e qytetarëve
- Kurrikulat për edukatën qytetare për nivelin parauniversitar dhe atë universitar të jenë plotësisht të integruara në të gjitha kurset trajnuese – të shoqëruara me trajnimet përkatëse për mësimdhënësit
- Sistem arsimor cilësor dhe kujdesi ndaj institucioneve/resurseve arsimore

3. Realizimi

- Ne do të avokonim për të shtyer përpara reformën e administratës publike me punëtorë të kualifikuar dhe të shkathtë
- Ne do të propozonim rregullativa dhe mekanizma për konsultim publik në faza të hershme për të gjtiha programet qeverisëse (qendrore dhe lokale)
- Ne do të bashkëpunonim me institucionet relevante për të përfshirë qytetarët në kohën e duhur, në vendimmarrje, dhe për të siguruar përfshirjen e ekspertizës së shoqërisë civile
- Ne do të zhvillonim kurrikula të integruara lidhur me edukatën qytetare – hap pas hapi për nivele të ndryshme arsimore – me një grup të ekspertëve ndër-disiplinar

1. Gjërat që mungojnë?

- Pasqyrë gjithëpërfshirëse për industritë ekzistuese me potencial për ekonominë -për të tashmen dhe për të ardhmen
- Strategji kohezive, për ekonominë e Kosovës dhe sektorët e saj
- Të dhëna kredibile dhe të verifikuara lidhur me vendet e punës dhe fuqinë punëtore për qëllime studimi dhe planifikim të strategjive.
- Sektori privat kryesisht është treg i punës i tipit të mbyllur – jo i lidhur me agjencitë e punësimit ose me zhvillimin e shkathtësive.
- Përkundër modernizimit, ekzistojnë vetëm disa struktura të pakta të punës të organizuara mirë dhe një efikasitet i ulët i punës.
- Ekziston një hendek i madh mes shkathtësive të reja (akademike në rritje) dhe shkathtësive të nevojshme për tregun aktual dhe të ardhshëm të punës.
- Lidhje e dobët (përveç në disa projekte) në mes të sistemit arsimor dhe biznesit.
- Orientim i pamajftueshëm për shkathtësi në TI dhe për produktet dhe shërbimet e ardhshme.
- Struktura adekuate për financim efektiv të start-upeve dhe bizneseve me kredi të garantuara mbështetëse (me shkallë të ulët të interesit).

2. Gjërat e kërkuara

- Databazë e besueshme dhe e qasshme për planifikim dhe punë në strategjitë zhvillimore
- Një “master plan” gjithëpërfshirës për zhvillimin e ekonomisë – duke i përfshirë të gjithë faktorët e nevojshëm si, arsimi, politikat për tregun e punës, etj.

- Politika dhe intervenime që përforcojnë zhvillimin e shkahttësive dhe koordinim me sektorin privat
- Programe speciale nga agjencia aktive për tregun e punës për gratë që të hyjnë në botën e punës (me orar jo të plotë, etj) dhe me kontrata të regjistruara.
- Një sistem publik për trajnime dhe aftësime profesionale me rregulla të certifikimit të zhvilluara nga të gjithë bashkë-aktorët e nevojshëm të përbashkët.
- Hulumtime gjithëpërfshirëse dhe intervenime në sektorët që kanë potencial për rritje, krijim të vendeve të punës dhe eksport .
- Struktura që ofrojnë qasje në financim për sektorin privat
- Përkrahje për modernizimin e prodhimit dhe të shërbimeve me përdorimin e teknologjive të reja

3. Realizimi

- Ne do të ndërtonim një iniciativë ekonomike kombëtare – po ashtu në bashkëpunim me aktorët e tregut të punës – për të zhvilluar databaza me të dhëna të besueshme, dhe të përdorshme për planifikim më të mirë dhe më efektiv
- Ne do të instalonim mekanzima që do të mbikëqyrin dhe garantonin realizimin e strategjive sektoriale
- Ne do të krijonim një agjenci nacionale të besueshme për tregun e punës me zyrat e saj regjionle dhe lokale për të sjellur në një vend nevojat e bizneseve bashkë me potencialin e fuqisë punëtore si dhe me sistemin arsimor në përgjithësi.

- Ne do të siguronim që grupet e margjinalizaura (gratë, minoritetet, rinia etj) të marrin kontrata të dinjitetshmë të punës që përfshijnë edhe kontributet shoqërore.
- Ne do të fillonim krijimin e një kornize për trajnim dhe aftësim profesional në përputhje me nevojat e tregut, duke përfshirë aktorët nga tregu i punës si partnerë për zhvillimin e kurrikulave, realizim dhe certifikim.
- Ne do të fillonim me hulumtime dhe bashkëpunime për themelimin e një fushe të re të perspektivës për TI – nevojave për shkathtësi, nevojave të tregut, bashkëpunim dhe opsione për tregtim, etj.
- Ne do të inkurajonim hulumtim dhe zhvillim për rritjen e efficiencës në sektorin privat
- Ne do të hulumtonim për opcione të reja për qasje në financa për start-up perspektivat -duke i përfshirë ose integruar fondet ekzistuese etj.

1. Çfarë mungon?

- Sistem shëndetësor funksional, i përballueshëm dhe i qasshëm në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetarët, me fokus në nevojat dhe mirëqenien e pacientëve
- Një sigurim shëndetësor i obligueshëm për të gjithë qytetarët
- Sistem informativ shëndetësor me statistika kredibile për shëndetin publik të qytetarëve të Kosovës
- Rrjeti i qendrave të referimit për disa shërbime të caktuara dhe të specializuara të kujdesit shëndetësor
- Një sistem funksional për furnizim dhe distribuim të medikamenteve të obligueshme në institucionet e shëndetit publik
- Pajisje dhe teknologji të reja në sektorin e shëndetësisë dhe staf të të aftësuar për të punuar me to
- Mbrojtje sociale për të gjithë qytetarët dhe grupet e margjinalizuara të shoqërisë
- Një sistem i mirfillt pensional për të mbrojtur në mënyrë të barabartë personat e moshuar
- Një çmimore për të gjitha shërbimet sociale dhe ndarje të mjaftueshme të buxhetit për komunat në mënyrë që ato të arrijnë implementimin efektiv të sistemit të decentralizimit të shërbimeve sociale siç parashihet me ligj
- Bashkëpunimi dhe bashkërendimi mes të gjithë hisedarëve dhe institucioneve përgjegjëse në sektorin e mirëqenies dhe të shëndetësisë
- Pjesëmarrje e barabartë dhe e drejtë e të gjitha grupeve të shoqërisë në sektorin e mirëqenies dhe të shëndetësisë
- Kushte të mira për punëtorët e kualifikuar dhe me shkathtësi të larta në sistemin e mirëqenies dhe të shëndetësisë

2. Çfarë duam?

- Një sistem të përfshirjes së rregullt të ekspertëve me njohuri dhe kompetenca, grupeve të interesit dhe shoqërisë civile në proceset e vendimmarrjes në këta sektorë
- Nivel më i lartë i regjistrimit të fuqisë punëtore në të gjithë sektorët
- Një sistem pensional i mirfillt, gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm që synon normat e shteteve të OECD-së (pensioni baras me 60% i pagës mesatare të fituar deri në pensionim)/ Niveli minimal i kontributeve pensionale për ata që punojnë pas vitit 1999)
- Një fond i mbrojtjes sociale, i pavarur, i mjaftueshëm, transparent dhe i paraparë si bazë për zhvillimin e sistemit të mbrojtjes së përgjithshme sociale efektive për të gjithë qytetarët
- Një grant i veçant nga buxheti qendror, për shërbimet sociale të decentralizuara të nivelit komunal, i njëjtë me grantet që jepen për arsim dhe kujdes shëndetësor specifik
- Rrjet gjithëkombëtar i sistemit të kujdesit shëndetësor, i përballueshëm për të gjithë qytetarët
- Sistem informatik i shëndetit publik, i qëndrueshëm, i besueshëm dhe lehtë i qasshëm për të dhënat për shëndetin
- Një sistem i drejtë i shpërndarjes së politikave sociale publike dhe shërbimeve për të gjithë qytetarët

3. Çfarë do të bënim ne?

- Ne do të aranzhonim një proces për zhvillimin e konsensusit nacional lidhur me pavarësinë dhe mbikëqyrjen e fondeve për sistemet e ndryshme të mbrojtjes shëndetësore dhe sociale
- Do ta shndërronim këtë në një bazë për një sistem ligjor nacional gjithëpërfshirës për mbrojtjen sociale i cili reflekton mbi nevojat e qytetarëve, specifikat e grupeve të ndryshme të margjinalizuara dhe të cenueshme të shoqërisë, në bazë të zbatimit në mënyrë efektive të ligjit të punës (sistemi tatimor, etj) dhe parashikimimin më të lehtë të mundësive buxhetore.
- Punët e shtëpisë (Domestic ëork) duhet të konsiderohen si “punë” e përfshirë edhe për mbrojtje sociale të ligjshme
- Ne do të krijonim lehtësira të ndryshme me qëllim të shmangies së punës informale në gjitha segmentet dhe sektorët
- Ne do të krijonim një mjedis të punës (legjislacioni, mekanizmat e zbatimit dhe inspektimit) që garantojnë kushte të denja për punë dhe jetë për punëtorët nga sektorët e shëndetësisë dhe të mirëqenies duke përfshirë edhe mundësitë për zhvillim profesional dhe nxitje për nëpunësit e kualifikuar dhe të aftë
- Ne do t'i modernizonim pajisjet dhe mirëmbajtjen e tyre në sektorin e shëndetësisë sipas sistemit – hap pas hapi, duke përfshirë partneritetet publiko-private
- Ne do të organizonim një sistem të qendrave për referencë në nivel qendror për t rajtime të veçnata me qëllim të/
- Ne do të themelonim një sistem furnizimi, shumë funksional, lehtë të gjurmueshëm dhe të lidhur me përditësimet me kohë nga lista e barnave esenciale

1. Çfarë mungon?

- Analiza e zbatimit të legjislacionit dhe rezultatet/problemet para përpunimit të ndryshimeve të mëtejme *ose të riformuluara në:
- Procesi legjislativ i bazuar në vlerësimin dhe reflektimin e zbatimit.
- Zbatimi i Ligjit të Punës në mënyrë të drejtë dhe të barabartë në të gjitha sektoret.
- Efekti i dialogut social në vendimmarrje dhe zhvillim të politikave.
- Mundësi të barabarta në botën e punës, pavarësisht moshës, gjinisë, përkatësisë etnike dhe orientimeve politike.
- Përpjekje më të bashkërenduara për punësimin e grave dhe të rinjve.
- Masa specifike, mekanizma për të siguruar kushte të denja të punës për gratë, të rinjtë,.
- Ushtrimi i duhur i kontrollit, inspektimi dhe sanksionimi lidhur me sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës.
- Inspeksion i punës që është efikas, i pavarur dhe efiqent.
- Formulë e duhur për caktimin e pagës minimale që reflekton të gjithë sektorët në mënyrë të barabartë.
- Një plan strategjik i realizueshëm për të redukuar informalitetin në sektorin privat.

2. Çfarë duam?

- Një Dialog i mirfillt social me më shumë kompetenca për vendimmarrje dhe më shumë përkushtim për mga ana e partnerëve socialë.
- Një vlerësim efektiv i zbatimit të legjislacionit në sferën e punës, duke i identifikuar mekanizmat dhe proceset të cilat e pengojnë zbatimin, e lidhur me adresinmin e duhur të përgjegjësive për ata që pengojnë.
- Një trajtim i barabartë për të gjithë punëtorët sipas Ligjit të punës (harmonizimi i kontratave të punës, modalitetet me sektorët specifik)
- Mbështetje shtesë për gratë në sferën e punës, veçanërisht për nënat dhe kujdestarët e familjes.
- Një balancë mes punës dhe jetës.
- Trajnime adekuate dhe mundësi për zhvillim të stafit profesional që merret me ligjin e punës , sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës.
- Paga të denja në të gjithë sektorët.

3. Çfarë do të bënim ne?

- Ne do të zhvillonim mekanizmin për Dialog Social specifik për të gjithë sektorët, në nivel kombëtar dhe atë lokal, duke e mbështetur një dialog konstruktiv mes punëdhënësve dhe punëmarrësve, po ashtu me mbështetjen e shoqërisë civile.
- Ne do ta ngrisnim cilësinë dhe sasinë e inspektimeve të punës përmes rekrutimit të stafit profesional, duke i fuqizuar më pas ata me kompetenca për sanksionimin e shkeljes së standardeve të punës dhe legjislacionit nëpër sektorë.
- Ne do t'i bindnim të gjithë aktorët e sferës së punës që të zbatojnë në mënyrë adekuate ligjin e punës përmes sundimit të ligjit duke caktuar gjoba të larta për ata që nuk e bëjnë këtë.
- Ne do të themelonim një sistem funksional të bashkërendimit dhe bashkëpunimit mes Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe makanizmave tjerë në nivel lokal të cilët punojnë në këto çështje.
- Ne do të fusnim gjoba të larta dhe sanksione kundër kompanive të cilat nuk i respektojnë masat për siguri dhe shëndet dhe standardet në vendet e punës, dhe do të theksonim se, lavdëronim dhe mbështesnim praktikat më të mira.
- Ne në mënyrë aktive do të mbështesnim nxjerrjen e marrëveshjes kolektive për të gjitha degët e sektorit privat dhe atij publik, në mes të sindikatave përkatëse dhe organizatave të punëdhënësve.



Pesë fusha
e ndërtojnë një bërthamë

Ideja për një Model Ekonomik dhe Social Kosovar është gjithëpërfshirëse dhe do të jetë bërthamë e Modelit social ekonomik “Kosova që Ne Duam!” Nevojiten të gjitha përpjekjet në secilën fushë dhe në po të njëjtën kohë sepse Fushat i mbulojnë problemet dhe nevojat e shumicës dërmuese në vend dhe ata meritojnë të jenë në krye të cilësdo agjende politike.
Vetëm me këtë lloj të sigurisë ekonomike dhe sociale (në cilindo prej shteteve fqinje) do të jetë e mundur të jetohet në paqe dhe miqësi në regjionin tonë.

Mënyra e realizimit të kësaj – hap pas hapi – tashmë e përcakton qëllimin tonë kryesor: Një jetë në një mjedis ekonomik të qëndrueshëm, me sigurim social, me kornizë ligjore kredibile e mbrojtur nga një sistem kontrollues i pavarur dhe me shumë perspektivë për gjeneratat e ardhshme përmes një arsimi modern.

Ndërvarshmëria e nevojave dhe ideve

Të gjitha kërkesat për zgjidhje të pesë fushave të Modelit Ekonomik dhe Social Kosovar janë të lidhura me njëra tjetrën. Krahasimi me kërkesat e ndryshme dhe idetë e përmendura tashmë tregojnë se sa ka dyfishime dhe ndërvarshmëri. Ja një shembull sa për ilustrim:

Pa një arsim më të mirë dhe ndërlidhjen e tij me botën e punës nuk do të ketë zhvillin ekonomik të qëndrueshëm.

Pa zhvillim ekonomik nuk do të ketë mënyrë për të pasur paga më të larta dhe kontrata të duhura të punës (luftimi i tregut të zi të punës!).

Pa më shumë kontrata të ligjshme të punës dhe kontribute sociale nuk ka mundësi që p.sh., të ketë kujdes të mjaftueshëm shëndetësor ose arsim më të mirë.

Në këtë mënyrë të gjitha idetë për zgjidhje janë të lidhura dhe duhet të jenë të përbashkëta. Prandaj, propozimet e izoluara paraqesin vetëm një pjesë të vogël të zgjidhjes së një problemi tepër të madh.

Realizimi

Është evidente se kjo nuk mund të realizohet menjëherë. Në të vërtetë kjo do të jetë një rrugë shumë e gjatë për pjesëtarët e shoqërisë. Por: sa më e gjatë të jetë rruga aq më heret duhet të nisesh. Prandaj, një ndryshim i jashtëzakonshëm i agjendës politike është më se i nevojshëm që tani. Qytetarët dhe organizatat e tyre duan të jenë të përfshirë në këtë agjendë.

Ata urgjentisht kërkojnë nga të gjitha partitë politike dhe të gjithë aktorët përkatës që të bashkohen për një pakt të kthimit kah e ardhmja e jonë. Ne do t'i mbështesim të gjithë politikanët e vullnetit të mirë dhe organet politike me burimet tona. Nga ana tjetër, ne nuk duam të presim më, meqenëse koha për të vepruar është tani! Gjithnjë e më shumë qytetarë po largohen nga vendi – kurse ne kemi nevojë për ta këtu! Prandaj, ne nuk kemi më durim dhe do të angazhohemi kundër gjendjes aktuale – duke i përdor të gjitha mjetet e lejueshme demokratike.

Ne do të kërkojmë nga përfaqësuesit tonë në parlamente dhe organe qeveritare në gjithë vendin që të na përkrahin dhe nëse po, të na tregojnë për mënyrën se si do të angazhohen për nevojat tona në të ardhmen.

Anëtarët e grupit kryesor

RIINVEST

kolegji-heimerer

Management Development Associates MDA

KEC

INSTITUTI GAP GAP INSTITUTE gap

FOL

KYC

Kosovo Local Government Institute

KOSOVA DEMOCRATIC INSTITUTE

INDEP

"PARAGON"

Human Care

SOLIDAR

KEG

UBT

inject

COLUMBUS

KOSOVA

we want
që duam
koje hoćemo

Siguri sociale
Zhvillim ekonomik
Punë dhe Jetë e Dinjitetshme